

DOKUDAILY

NUMRI I NËNTË

EDICIONI XXIV

E SHTUNË, 9 GUSHT 2025



FOTO: FERDI LIMANI

NJË KUFË PËR NEGOCIATAT

Në ditën e parafundit të Dokufest-it, një programim “back to back” i dy filmave që trajtonin rëndësinë dhe kufijtë e multilateralizmit ma krijoi një përvojë jokongruente, por gjithsesi domethënëse. Në “The Helsinki Effect”, që gjithashtu hapi këtë edicion të festivalit, Arthur Franck përpiqet ta shpëtojë në mënyrë krijuese Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë nga rutiana e vet, për t’ia rikthyer një rol vendimtar në përfundimin e Luftës së Ftohtë. Duke përdorur Inteligjencën Artificiale për të transformuar transkriptet e Henry Kissinger në klipe zanore dhe duke shfaqur fotografi të Leonid Brezhnev në rroba banjoje, filmi nis me një ton ambivalent: a e tregoi konferenca 3-vjeçare, me ritmin e saj prej kërmilli, se diplomacia e ngadaltë funksionon?

Pas të qeshurave së bashku me krijuesin për fjalimin mbi 30-minutësh të Çauçeskut në konferencë, momentet e fundit i filmit kalon shpejt tek nënshkrimi i Marrëveshjeve të Helsinkit dhe efekti zinxhir që patën ato në krijimin e kapitujve të ndryshëm të Komiteteve të Helsinkit në gjithë Evropën Lindore. Ne na duket sikur duhet të besojmë se kështu ndodh ndryshimi i vërtetë: diplomaci në nivele të larta politike, ndërkohë që qytetarët mbajnë qeveritë e tyre përgjegjëse; duke kërkuar demokraci mbi vlera të shkruara në letër.

Menjëherë pas kësaj, u nxitova të shkoja në DokuKino Plato për të parë “Coexistence, My Ass!”, ku ndoqa punën e shkëlqyer të Noam Shuster Eliassi, një aktiviste dhe komediane hebreje, që përpiqet ta ndryshojë botën duke qeshur me të herë pas here. Eliassi nuk është naive: e rritur në një komunitet bashkëpunues të quajtur “Oazi i Pages”, i krijuar nga izraelitë dhe palestinezë që donin t’i rritnin fëmijët e tyre në frymën e bashkëjetesës, ajo hyn në komedi pas një periudhe pune në Kombet e Bashkuara, pa shumë sukses. Gjatë gjithë filmit e shohim Eliassin duke luftuar pa kompromis për barazi, pavarësisht urrejtjes online që merr për shkak të kritikës së saj ndaj okupimit nga Izraeli të West Bank dhe Gazës.

Filmi merr një kthesë në ton pas sulmit të 7 tetorit, gjatë të cilit u vranë mbi 1,000 izraelitë, dhe Eliassi përpiqet të përballet me rolin e saj si figurë publike: si të vajtosh, kur pa u ndalur qeveria përdor sulmin për ta rrafshuar Gazën, dhe numri i viktimave rritet përditë? Nga fundi, e shohim Eliassin duke protestuar në rrugë kundër qeverisë së Netanyahu, duke këmbëngulur se nuk mund të ketë demokraci në Izrael nëse ajo është vetëm për hebrenjtë. E shohim Eliassin duke qarë teksa sheh pamje nga Gaza: një skenë që ndoshta na prek shumicën prej nesh, teksa e shohim gjenocidin të shpaloet drejtpërdrejt në TV, duke u ndier të pafuqishëm.

Ndërsa “Coexistence, My Ass” nuk merret drejtpërdrejt me multilateralizmin, mund ta lexojmë zhgënjimin e Eliassis me OKB-në dhe kufijtë e drejtësisë ndërkombëtare për të ndaluar fushatën e Izraelit, si një tregues të qartë se, pavarësisht gjithçkaje, diplomacia me ritme breshkeje mund të mos funksionojë për të gjithë. Kjo bëhet ndoshta edhe më e dukshme kur mendojmë se shtetet evropiane po shqyrtojnë njohjen e shtetit të Palestinës si përgjigje ndaj urisë së shkaktuar nga njeriu në Gaza: një kthim te Marrëveshjet e Oslos të arritura në mesin e viteve 1990, të cilat pak kush do t’i quante të suksesshme. Cili do të ishte efekti i Oslos, kur shohim se 30 vite më vonë jemi dëshmitarë të një gjenocidi të transmetuar drejtpërdrejt, pa asnjë mjet ndërhyrjeje? Duke parë këto dy filma njëri pas tjetrit, humbet besimi në rendin multilateral, por falë Eliassis, e rifiton atë tek forca e shpirtit njerëzor.

Ndoshta, në fund, kjo është e vetmja gjë tek e cila mund të mbështetem: përpjekja e pandalshme e individit për të luftuar për shpirtin e komunitetit të vet.

Shkruar nga Lura Limani



FOTO: GRESA NUREDINI

REKOMANDIME

FLOPHOUSE AMERICA / 78'
VIEW FROM THE WORLD



SHTËPIA E KULTURËS 16:00

KNEECAP / 105'
FICTION/NON-FICTION




DOKUKINO 17:30

PALACE OF YOUTH / 66'
SLANTED & ENCHANTED: MUSIC ON FILM



SHTËPIA E KULTURËS 20:30

PULSE OF BERAT
DOKUNIGHTS



KINO LUMI 22:30

SOUND METAPHORS DJS,
SLEEP D (BUTTER SESSION), GENÇ ELEZAJ
DOKUNIGHTS



SONAR STAGE 23:59

DOKUTALKS

Kur Imazhet Jehohjnë



FOTO: SUER CELINA

Në një kohë kur imazhet kurrë nuk zhduken plotësisht, por riformësohen vazhdimisht, “Reassembled: Collage, Memory, and the Hybrid Image” bëri bashkë katër artistë, veprat e të cilëve kthejnë fragmente nga e kaluara në rrëfime me kuptim. I moderuar nga Dea Gjinoçi dhe i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, ky DokuTalk u zhvillua më 8 gusht në Shkollën e Muzikës “Lorenc Antoni”, duke ofruar një eksplorim intim të mënyrave se si kujtesa, qofshin ato personale, kolektive apo politike mund të rindërtohen përmes praktikave artistike hibride.

Biseda u hap duke u pajtuar njëzëri se kolazhi është më shumë sesa një teknikë estetike, por që është një filozofi tregimore. Materiale të gjetura, tekstura digjitale, dokumente arkivore dhe imazhe të rindërtuara mund të shërbejnë si ura mes së kaluarës dhe së tashmes, mes asaj që kujtohet dhe asaj që është fshirë. Për kineastët Ermela Teli, Sara Rajaei, Durim Klaiqi dhe Blerta Haziraj, akti i rizhvillimit nuk ka të bëjë vetëm me përballjen me mungesën, por edhe me ruajtjen e pranisë.

Ermela Teli foli për hulumtimin në arkivat shtetërore të Shqipërisë, ku gjeti shirita 8mm të xhiruar në shtëpi nga xhaxhai i saj në vitet '80. Në pamje të parë, imazhet si dasma, festa familjare, momente të përditshme dukeshin të paprekura nga politika. Por, siç shpjegoi ajo, “çdo gjest, çdo kuadër, çdo zgjedhje se ku ndalet kamera” mbante peshën e padukshme të kontrollit estetik të shtetit. Pas fytyrave që buzëqeshnin dhe harmonisë së inskenuar fshihej dhimbja e pathënë e familjes: një baba në burg, një nënë në spital, një hije e shtypjes politike. Shiu u bë një simbol i përsëritur për të, një prani melankolike që përshkonte momentet vendimtare të jetës së saj. Për Telin, gjetja e gjurmëve të atij shiu në piktura, filma dhe muzikë ishte një mënyrë për të pohuar se përjetimet e saj nuk ishin iluzione të vetmuara.

Tutje, Blerta Haziraj e prezantoi publikun me faqet e harruara të aktivizmit letrar të grave në Jugosllavinë e pasluftës. Hulumtimi i saj mbi Frontin Antifashist të Grave të Kosovës e çoi tek një revistë e pas Luftës së Dytë Botërore, ekzistencën e së cilës arkivat shtetërore fillimisht e kishin mohuar. Këmbëngulja e saj bëri të mundur zbulimin e saj, së bashku me dhjetëra fragmente të tjera nga gazeta dhe dokumente të komunitetit.

Haziraj foli për “gjallërimin” e gjuhës historike, për t’i dhënë jetë zërave të grave, kontributet e të cilave shpesh ishin varrosur nën narrativat zyrtare të ngurta. Për të, puna me arkivat nuk është neutrale, përkundrazi është një akt rezistence, një pyetje e hapur mbi mënyrën se si tregohet historia dhe kush ka të drejtë ta tregojë atë. Gjersa, Sara Rajaei e zhvendosi bisedën tek ndërthurja mes personale dhe universale. Në filmin e saj, ajo heq çdo tekst identifikues nga imazhet, përdor rrëfim në anglisht dhe shmang çdo tregues të vendndodhjes, duke e ngadalësuar qëllimisht procesin e zbulimit për publikun. Kjo vonesë, shpjegoi ajo, krijon hapësirë që shikuesit të lidhen emocionalisht përpara se ta kategorizojnë tregimin gjeografikisht apo politikisht.

Puna e saj ndërthur lëvizjen aktuale për lirinë e grave në Iran me betejat e hershme historike, duke përdorur arkiva personale dhe familjare për të sjellë ndjesi të përbashkëta të zhvendosjes, mallëngjimit dhe qëndrueshmërisë. Durim Klaiqi diskutoi mbi sfidat e përballjes me materiale historike të paplota. Duke përdorur rindërtime 3D dhe ekrane të errëta të vendosura qëllimisht, ai i lejon mungesës të flasë po aq fort sa prania. Boshllëqet në filmat e tij janë të qëllimshme; shikuesit ftohen të mendojnë, të plotësojnë pjesët që mungojnë dhe të bëhen pjesë e aktit të rindërtimit.

Në gjithë këtë diskutim, doli në pah një e vërtetë: kujtesa nuk është lineare. Ajo kthehet pas, kalon mbi disa momente, fshihet dhe rishfaqet. Trauma nuk zhvillohet sipas rendit kronologjik, as gëzimi. Në duart e këtyre artistëve, tregimi hibrid bëhet një mënyrë për ta nderuar këtë kompleksitet, për t’i rezistuar thjeshtimit të përvojave të jetuara në afate kohore.

Në mbyllje të diskutimit, u bë e qartë se “Reassembled” ishte më shumë se një bisedë për artin; ishte një reflektim mbi mënyrën se si e bartim të kaluarën në të tashmen. Në çdo fragment, qoftë një fotografi e zbehur, një prerje gazete apo një kuadër filmi fshihet një histori që pret të tregohet sërish, ndryshe, dhe ndoshta më e vërtetë seç ishte më parë.

Shkruar nga Shefket Bujari

Partneriteti që bashkon biznesin me kulturën në zemër të Prizrenit



Për një dekadë e gjysmë, Baruti AG është një histori suksesi që lidh Kosovën me tregjet ndërkombëtare, duke ofruar shërbime të shkëlqyera për kompani botërore. Me një prani të fortë edhe në Prizren, Baruti nuk është vetëm një punëdhënës i rëndësishëm, por edhe një partner i palëkundur i jetës kulturore të qytetit.

Bashkëpunimi i sivjetmë me DokuFestin është dëshmi e përkushtimit të kompanisë për të mbështetur artin, debatin dhe krijimtarinë, duke kontribuar në rritjen e profilit kulturor të Prizrenit në skenën botërore.

Këtë vit, nën temën provokuese “Endless Greed Mental Void”, Baruti rikonfirmon vlerat që e udhëheqin, ndershmërinë, guximin për të mbajtur qëndrime dhe përgjegjësinë shoqërore, duke e bërë këtë partneritet një shembull të shkëlqyer se si biznesi dhe kultura mund të ecin krah për krah drejt suksesit dhe ndikimit afatgjatë.

Në këtë intervistë, Dren Selimi nga Baruti ndan mendimet për rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe ndikimin e tij në komunitet.

DD: Bashkëpunimi juaj me DokuFestin; a mund të na tregoni dobitë e këtij partneriteti dhe se si ndikon në këtë klimë kulturore?

DS: Bashkëpunimi me DokuFestin është një angazhim i sinqertë për të mbështetur një platformë që sjell gjallëri, debat dhe krijimtari në zemër të Prizrenit, një qytet me rëndësi të veçantë për ne, pasi aty kemi një nga zyrat tona.

DD: Tematika e këtij viti “Endless Greed Mental Void” i flet, ndër të tjera, edhe të paturit guxim për të mbajtur qëndrime të rëndësishme. Si ju flet juve kjo temë?

DS: Kjo temë prek një realitet të rëndësishëm të kohës sonë dhe fton në reflektim të thellë. Ajo na kujton sa e nevojshme është të kemi guxim për të mbrojtur vlera që shpesh harrohen në një shoqëri dinamike. Si kompani, ne besojmë në qëndrime të qarta, ndershmëri dhe përgjegjësi shoqërore, vlera që përputhen plotësisht me frymën që DokuFest përçon përmes këtij programi.

DD: Mbështetja juaj për artin dhe kulturën është e vërejtshme dhe e qëndrueshme. A mund të na tregoni më shumë mbi suksesin duke mbështetur ngjarje si DokuFest?

DS: Ne kemi zgjedhur që mbështetja për artin dhe kulturën të jetë pjesë thelbësore e përgjegjësisë sonë shoqërore. Përmes bashkëpunimeve si ai me DokuFestin, kemi parë ndikim të qëndrueshëm, nga rritja e ndërgjegjësimit kulturor deri te përf forcimi i imazhit të Prizrenit si një destinacion për ngjarje të klasit botëror. Ky është një sukses që e ndajmë me komunitetin dhe me të gjithë partnerët tanë.

DD: A mund të na flisni se si ndiheni për këtë bashkëpunim, që ndër vite ka patur vizibilitet të madh ndërkombëtar?

DS: Ndjehe mi jashtëzakonisht krenarë që jemi pjesë e një ngjarjeje që jo vetëm që ka rritur profilin kulturor të Kosovës, por ka vendosur edhe Prizrenin në hartën e festivaleve më të njohura ndërkombëtare të filmit dokumentar. Si një kompani që operon edhe në këtë qytet, ky bashkëpunim ka një rëndësi të veçantë për ne dhe reflekton përkushtimin tonë ndaj komunitetit.

Yll Limani dhuron 10,000 euro për Kinemanë e Gjelbër të DokuFestit



FOTO: ELMEDINA ARAPI

Pak orë para se të ngitej në skenën e DokuNights për të performuar para një audience të zjarrtë, artisti i njohur kosovar Yll Limani bëri një gjest që i tejkalon kufijtë e muzikës. Me një dhuratë prej 10,000 eurosh, ai iu bashkua nismës “DokuFest Green Cinema”, duke kontribuar në realizimin e vizionit të organizatës për një kinema plotësisht të qëndrueshme, të lëvizshme dhe miqësore me mjedisin.

Ky kontribut shënon një moment të rëndësishëm për projektin, i cili për vite me radhë ka qenë sinonim i afrimit të magjisë së filmit në hapësirat më të papritura, nga sheshet e qyteteve deri në fshatrat e thella të Kosovës. Solar Cinema i DokuFestit, një projekt i shpërblyer me çmime dhe i dashur për publikun, është zhvilluar si një platformë kulturore që përdor energjinë diellore për të shfaqur filma falas, nën qiellin e hapur, për audienca të të gjitha moshave.

Por me Green Cinema, DokuFest synon të bëjë hapin tjetër drejt një të ardhmeje edhe më të gjelbër. Plani është që Solar Cinema të transformohet në një kinema mbi rrota, të pajisur me një furgon elektrik 100%, që nuk lëshon asnjë grimë ndotje. Ky furgon do të shërbejë si bazë për shfaqje filmash, duke udhëtuar në vende ku kinematë tradicionale nuk arrijnë, dhe duke e kthyer hapësirën publike në një pikë bashkimi për komunitetin.

Sipas DokuFestit, vizioni është i qartë: të kombinohet fuqia e tregimit filmik me kujdesin për mjedisin, duke treguar se kultura dhe qëndrueshmëria mund të ecin dorë për dorë.

“Falënderojmë nga zemra Yll Limanin që iu bashkua dhe i besoi vizionit tonë për një kulturë të qëndrueshme, për një kinema që nuk e dëmton planetin”, thuhet në njoftimin zyrtar të DokuFestit.

Ky gjest i Limanit nuk është vetëm një kontribut financiar, por edhe një mesazh i fortë mbi rolin që mund të luajnë artistët në përkrahje të kauzave që kanë ndikim shoqëror e mjedisor.

DokuFest ka bërë të ditur se mirëpret edhe donacione tjera.

“Projekti mbetet i hapur për donacione nga artistë, partnerë, kompani dhe njerëz që duan t’i bashkohen kësaj lëvizjeje dhe besimit tonë se kinemaja nuk ka vetëm fuqinë të pasqyrojë botën por edhe ta ndryshojë atë”, thuhet në njoftim.

Solar Cinema ka funksionuar deri më tani duke përdorur panele diellore për të furnizuar projektorët dhe pajisjet e nevojshme për shfaqje filmash. Ky model ka treguar se përmbajtja kulturore cilësore mund të ofrohet pa gjurmë të mëdha mjedisore. Me Green Cinema, ky koncept do të zgjerohet, duke siguruar jo vetëm energji të pastër, por edhe lëvizshmëri më të madhe dhe teknologji të avancuar për shfaqje më cilësore.

Furgoni elektrik që synon të blejë DokuFest do të jetë baza logjistike dhe teknike e projektit. Ai do të lejojë që ekipi i festivalit të shkojë në vendet më të largëta të Kosovës e rajonit, duke ofruar jo vetëm filma, por edhe biseda, punëtori dhe aktivitete komunitare. Kështu, Green Cinema nuk është thjesht një kinema lëvizëse, është një platformë e gjallë për shkëmbim kulturor dhe ndërgjegjësim mjedisor.

Projekti mbetet i hapur për donacione nga kushdo që beson në fuqinë e filmit për të ndryshuar botën. Siç thekson DokuFest në faqen e tij për donacione (linku: <https://dokufest.com/al/donate>) kontributet do të ndihmojnë në blerjen e furgonit elektrik dhe mbajtjen e tij në lëvizje, duke mundësuar që tregimet të arrijnë tek njerëzit dhe vendet që kanë më shumë nevojë për to.

“Pa bileta, pa mure, vetëm bashkimi i komunitetit në një vend ku kinematë nuk arrijnë”, është motoja që përmbledh shpirtin e kinemasë miqësore me mjedisin. Ky është një projekt ku kultura nuk është luks, por e drejtë; ku teknologjia nuk është vetëm komoditet, por mjet për ndryshim pozitiv.

Falë mbështetjes së Yll Limanit dhe të gjithë atyre që do t’i bashkohen nismës, DokuFest Green Cinema po përgatitet të hapë një kapitull të ri, një histori që do të udhëtojë në rrugë, nëpër sheshe, dhe mbi të gjitha, në zemrat e publikut.

DOKUNIGHTS

Radha shtrihej nga portat e kalasë, nëpër kodër e deri te Kalaja. E gjithë audienca e mbushi përplot skenën në kala, duke ndryshuar plotësisht relievin e saj, e dukej si një masë e tërë e gjallë në pritje të emocioneve të forta. Fansa që ngjiteshin në muret e kalasë duke mbushur çdo centimetër të hapësirë. Mbrëmë ishte një natë e pakrahasueshme dhe ishte e vërejtshme, ndërsa superylli i Kosovës Yll Limani doli në Sonar Stage në një shfaqje të jashtëzakonshme me të gjitha biletat e shitura, e me të gjithë qytetin e Prizrenit aty për ta përshëndetur.

Si një i huaj që ka jetuar në qytet vetëm për dy muajt e fundit, ka qenë shumë e mrekullueshme të shoh entuziazmin e të gjithë atyre që kam takuar në përgatitjet për këtë performancë. Ky event u njoftua në fund të qershorit, menjëherë u caktua si një nga ngjarjet më të mëdha në historinë e DokuNights, shumë nga miqtë e mi nuk mundën ta përmbanin veten para mundësisë së njërit prej yjeve më të mëdhenj të popit në vend që të ndriçojë Prizrenin. Dhe ai nuk zhgënjëu askënd.

Nuk kam qasje në peshën kulturore që fshihet pas punës së tij, as nuk i kuptoj tekstet e tij, por mbrëmë ishte e lehtë të kuptoja pse ai ka kultivuar një numër kaq të madh ndjekësish. Atmosfera ishte e nxënë prej dëshirës për të përjetuar diçka unike, turma që brohoriste emrin e tij. Yll Limani doli në skenë dhe menjëherë e shkaktoi një stuhi. I ndihmuar nga një ansambël i talentuar që luajtën drejtpërsëdrejti në bateri, tastierë dhe back vocal-e, ai ofroi një qasje më instrumentale në diskografinë e tij. Ai këndoi drejtpërsëdrejti plot me emocion. I ulur në një mur mbi turmën, ishte e lehtë të shihje gëzimin në fytyrat e të gjithëve ndërsa Limani këndoi një baladë tjetër të përzemërt, secila një letër dashurie për fansat e tij.

Një natë e paharrueshme

Unë nuk flas shqip, por këngët e tij ende prekin thellë, meloditë e tij të zjarrta dhe shkrimi i këngëve të dhimbshme, të gjitha dëshmi të dashurisë dhe shpresës, duke kapërcyer barrierat gjuhësore dhe duke transmetuar drejtpërdrejt në zemër. 'Qaj', një nga këngët e mia të preferuara prej tij, i shndërroi me krenari instrumentalet tradicionale shqiptare në një himn tërheqës dhe emocionues, ndërsa Limani madje na dhuroi një këngë të papublikuar, vokali i tij i gjerë arriti të na rrënqethte. Turma vetë ishte në ekstazë, një gjendje adhurimi e pastër, me duar që tundnin, me telefona të ndezur, të pushtuar nga fuqia e Limanit ndërsa ai ngrihej në lartësinë e rastit. Në fund të natës, ishte e qartë se Prizreni kishte dëshmuar diçka historike.

Sonte, DokuNights përfundon ashtu siç filloi: me një festë gjigante. Së pari, menjëherë pas Orkestrës Shkodra të edicionit të kaluar, producentët Oda3 prezantojnë një kapitull tjetër në linjën e pasur të muzikës tradicionale të Shqipërisë përmes ansambllit Puls i Beratit, në një koncert që nderon të kaluarën dhe të tashmen e Beratit, me këngë që pasqyrojnë trashëgiminë e qytetit si në udhëkryq midis periudhës para-osmane dhe ndikimit evropian. Me këngëtarë veteranë, instrumentistë virtuozë dhe një shpirt të lirë, Kino Lumi do të transformohet në një festë të madhe.

Pastaj, do të shkojmë në fortesë për herë të fundit, ndërsa tre grupe të shkëlqyera e mbyllin festivalin me diçka të veçantë: një festë gjithë natën, me DJ-të e Sound Metaphors, Nemo dhe Castro, që sjellin energjinë e tyre zanore të ndritshme dhe shumëngjyrëshe në punime, Sleep D nga Melbourne që rrit ritmin me një set hipnotik të mbushur me muzikë house, ambient, acid, pushime të dubluara dhe mutacione të shkurrev dhe Genc Elezaj nga Kosova që shtrihet në lindjen e diellit me një përzierje eklektike plot me kthesa marramendëse në të.

Shkruar nga Gus Edgar-Chan




FOTO: FERDI LIMANI

General Sponsor



Principal Partner



Principal Partner



Golden Sponsor

